



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 246, Datë 30.09.2025

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “GREEN VALUE” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, si dhe 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2382/3 prot., datë 23.09.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “GREEN VALUE” shpk për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GREEN VALUE” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2382 prot., datë 29.08.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 208, datë 09.09.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 09.09.2025 dhe 10.09.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 18.09.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua u botua në dy gazeta zyrtare, në rrjetet sociale të institucionit edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- ERE, me shkresën nr. 2381/4 prot., datë 10.09.2025, ka ftuar shoqërinë në një seancë dëgjimore për të sqaruar dokumentacionin që lidhet me mbështetjen financiare për ushtrimin e veprimtarisë. Duke qenë se kjo shkresë është kthyer mbrapsht nga shërbimi postar, me emailin e datës 15.09.2025, ERE i ka dërguar shoqërisë një kopje të skanuar të shkresës.

- Në seancën e zhvillua në mjediset e ERE-s, në datën 18.09.2025, shoqëria ka dhënë sqarimet përkatëse dhe në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2381/7 prot., datë 19.09.2025, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e e kërkuar për këtë aplikimi.

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Nga analizimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Ankesit A dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në zbatim të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, e miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “GREEN VALUE” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “GREEN VALUE” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI